



01/Nr. 3437 /2020
Data: 23.06.2020

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tretë -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.05.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Miratimi i planit të punës së komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2020.
4. Miratimi i raportit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2019.
5. Miratimi i raportit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2019.
6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2019.
7. Njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.
8. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2020.
9. Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
10. Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave.
11. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për tre mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.
12. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- tash jemi bërë tri opozita dhe është mirë që me shënuar se cila opozitë është kundër dhe cila është pro për shkak se tri opozita po bëhen të njëjtë kur është në pyetje votimi. Unë mendoj që duhet të ceket subjekti i partisë e cila është kundër.

Mefail Suma thekson:- kur opozita është kundër konsiderohet si vendim i një anshëm dhe është mirë me u përmendur edhe me emra se kur të voton dikush prej opozitës kundër.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendoj se nuk ka asgjë të keqe nëse shënohen emrat se kush është për dhe kundër. Nuk besoj që është anti ligjore kjo çështje.

Kryesuesi thekson:- sa i përket votimit mund t'i shikojmë praktikën e komunave të tjera dhe do të konsultohem me zyrën ligjore për këtë çështje. Përmendja e emrave nuk më duket etike dhe pak e tepërt për shkak se procesverbalet mbesin. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- në KPF jemi dakorduar dhe e kemi parë të arsyeshme që këtë pikë me diskutuar për shkak të pandemisë por ndoshta edhe në mbledhjet e tjera do ta diskutojmë deri sa të kalon pandemia. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- në dy mbledhjet e jashtëzakonshme të cilat i kemi pasur jeni njoftuar për aktivitete dhe punët të cilat janë bërë gjatë situatës me pandeminë. Nga muaji shkurt jemi mundur me i zbatuar vendimet të cilat janë dërguar nga niveli qendrorë . Edhe pse kemi pasur mungesë stafi vazhdimisht ishim në pikën kufitare dhe kemi pasur 5282 kontrolla të shoferëve të cilat janë kryer dhe prej tyre 59 udhëtarë që në bazë të rekomandimeve të institutit i kemi përcjell për karantinë në qendrën e studente në Prishtinë. Gjatë muajit majë edhe pse nuk ka përfunduar i kemi pasur 6421 kontrolla prej tyre 165 janë vazhduar për qendrën e studentëve në Prishtinë. Gjatë muajit prill në QKMF i kemi ndërprerë disa shërbime në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të cilat ishin për të mirën dhe për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, mirëpo me zbutjen e masave këto shërbime kanë filluar dhe sot kemi pranuar vendimin nga qeveria që e liron secilin udhëtarë nga karantina por secili udhëtarë që do të kalon do të ketë vetëm vetizolim shtëpiak . Ne kemi me vazhduar që me i pasur ekipet mjekësore në kufij. Janë ndarë edhe ndihma për familjet me nevojë dhe numri është 1121 pako të cilat janë shpërndarë gjatë kësaj periudhe. Gjithsejtë ishin shtatë persona me COVID pozitiv . Me datë 23. 05.2020 e kemi pasur edhe pacienten e fundit e cila e ka kryer pjesën e vetizolimit dhe për momentin nuk kemi asnjë të infektuar në komunë.

Mehmet Ballazhi thekson:- kush e ka përcaktuar ndërprerjen e disa shërbimeve në QKMF dhe cilat janë ato shërbime. A ka pasur vullnetarë që janë kyçur për me kryer shërbime gjatë kohës së pandemisë dhe nëse ka pasur do të ishte mirë me u stimuluar me mjete financiare.

Teuta Shkreta thekson:- përshëndes drejtoreshën për punën të cilën e ka bërë së bashku me kryetarin e komunës dhe stafin e mjekësisë familjare.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket shërbimit të vaksinimit dhe vizitat për nëna për fëmijë janë ndërprerë nga Ministria e Shëndetësisë nëpër të gjitha komunat. Vizitat specialistike që i kemi pasur pediatri dhe internistin janë ndërprerë me vendim të drejtorisë. Në muajin maj këto shërbime kanë filluar me funksionuar. Ne i kemi pasur katër vullnetarë dhe ministria çdo ditë e përditëson listën e vullnetarëve dhe besoj që do ti paguan për shkak se ende janë duke vazhduar

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

3. Miratimi i planit të punës së komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- komiteti është funksional por planin e punës nuk është miratuar në kuvendin e komunës dhe në momentin që do të miratohet plani i punës komiteti do të vazhdon me mbajtjen e seancave. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- a ka rregullore të punës për këtë komitet.

Medina Imishti thekson:- rregullore të punës për këtë komitet nuk ka përveç strategjisë katër vjeçare për persona me aftësi të kufizuara por edhe asaj i ka skaduar afati.

Mefail Suma thekson:- komiteti në fjalë nuk është i përkohshëm dhe është mirë të këtë rregullore që t'i dimë kompetencat e këtij komiteti se çfarë punë do të kryen.

Kryesuesi thekson:- këtij komiteti ja kemi mundësuar një takim pune me komitetin e komunës së Kaçanikut për me parë si model se si ka funksionuar në komunën e Kaçanikut .

Sead Vila thekson:- a është Hendikosi si degë në Han të Elezit apo nëndegë. Disa pika të cilat i kanë paraparë në plan janë shumë të mira dhe besoj që kanë me i realizuar por ka pika që nuk kanë të bëjnë me këtë komitet dhe është mirë që të ndryshohen për shkak se nuk është kompetencë e tyre që me u marrë me çështjet buxhetore apo për rregulloren për taksa dhe tarifa.

Kryesuesi thekson:- në plan është paraparë me diskutuar për çështje të buxhetit sepse edhe ata mund të kenë kërkesat e tyre të cilat kanë të bëjnë me mjete financiare. Në mbledhjen e parë kanë planifikuar me diskutuar për çështjen e themelimit të Hendikosit për shkak se është nëndegë dhe besoj me angazhimet që do ti kenë do ta bëjnë degë sepse një anëtare e këtij komiteti e ka marr përsipër themelimin e degës së Hendikosit në Han të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- themelimi i Hendikosit sipas planit është muaji Prill dhe nëse e miratojmë si plan pune duhet ta dimë që muaji prill ka kaluar dhe duhet të ndryshohet.

Kryesuesi thekson:- unë mendojë që edhe planet e tri komiteteve të tjera do të kalojnë për diskutim në muajt e tjerë për shkak se pandemia i ka ndërprerë dhe do t'i zhvendosin.

Teuta Shkreta thekson:- do të jem shumë kritike ndaj kësaj kryesueses së këtij komiteti. Dua të jetë më përgjegjëse dhe a ka qenë aktive në këtë kohë të pandemisë pasi që është kryesuese e një kategorie të ndishme.

Kryesuesi thekson:- informacion nuk kam sa ka qenë aktive për shkak se si komitete është themeluar tash. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Prezent ishin 14 këshilltarë të kuvendit të komunë.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2020

4. Miratimi i raportit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- si anëtarë i këtij komiteti kam vërejtje te pjesëmarrja e drejtorëve për shkak se nuk po marrin pjesë në mbledhje të komitetit për komunitete.

Sabrije Krasniçi thekson:- vërejtjet e dhëna nga ky komitet a i keni rishikuar sepse ishin vërejtje shumë të qëlluara.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Prezent ishin 14 këshilltarë të kuvendit të komunë.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2019

5. Miratimi i raportit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2019

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Prezent ishin 14 këshilltarë të kuvendit të komunë.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2019

6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- këshilli i ka mbajtur takimet e rregullta dhe janë diskutuar të gjitha problemet që kanë të bëjnë me sigurinë . Përveç materialeve të cilat i kemi dërguar diçka të veçantë nuk kam.

Mehmet Ballazhi thekson:- te bizneset të cilat ushtrojnë veprimtarinë te kufiri u janë shqiptuar dënime për shkak të keqpërdorim të ujit dhe kanë potencuar që policia i ka dënuar. Nuk e di sa ka drejtë policia me i dënuar për deri sa është inspektorati i komunës.

Rufki Suma thekson:- kjo është në vitin 2020 dhe mund të jetë pjesë e raportit për vitin 2020. Është ankesë e qytetarëve ndaj atyre personave të cilët vazhdimisht ujin e lënë duke rrjedhë dhe vazhdimisht magjistratja rrinë me ujë dhe shkaktohen aksidente në komunikacion. Këtë çështje polica e ka në kuadër të punës së tyre. Policia i ka shënuar tiketat dhe ja ka dorëzuar inspektorit për me i ekzekutuar dhe në këtë rast nuk bëhet fjalë për keqpërdorim të ujit por për ata që vazhdimisht e lënë duke rrjedhë dhe e rrezikojnë komunikacionin.

Florim Shkreta thekson:- këto pika për çdo vit po diskutohen por nuk po kanë rezultat. Është diskutuar për qenët me pronarë dhe ju është dhënë vërejtje, mirëpo unë asnjë qenë nuk e shohë me pronarë në Han të Elezit që ka ndonjë maskë që do të thotë nuk është bërë asgjë. Për çështjen e qenve endacak fajin ja kanë lënë qeverisë që mendoj që nuk është në rregull për shkak se jemi komunë dhe duhet të bëjmë zgjidhje. Është diskutuar për çështjen e kompanisë “Bektellenka” por ajo ka dalur nga Kosova. Në bashkëpunim me policinë keni biseduar për largimin e fëmijëve nga pika kufitare dhe nuk është mirë vetëm të bisedohet për shkak se fëmijët vazhdimisht rrinë te kufiri. Është biseduar për katër vend kalimet ilegale për te hekurudha por hekurudha do të rinovon pjesën e vetë dhe ndoshta është e mundur që me kufizuar kompletë që mos me pasur dalje ilegale. Komuna a ka bërë ndonjë plan për ndonjë nënkallim apo mbikalimi me rregulluar për shkak se është vend i rrezikshëm. Çështja e kanalizimeve vazhdimisht diskutohet por zgjidhje nuk ka sepse përballë QKMF-së kompletë ajo pjesë ka probleme me kanalizim. Është diskutuar për ndotje të ambientit por tri apo më shumë herë kam kërkuar që aparatin matës me vendosur diku tjetër. Është diskutuar për mbrojtjen e pyjeve dhe prerjen ilegale të tyre dhe nuk është mirë vetëm me diskutuar për këtë pikë por duhet të ndërmerren masat për shkak se prehen pyjet dhe drutë transportohen nëpër komuna tjera. Nuk keni se çka të diskutoni për ndriçim publik sepse e keni bërë dhe nuk është bërë në rregull për shkak se shkon me zonë kadastrale ata të cilët paguajnë më shumë tatim duhet t'i dërgohet ndriçimi e jo vetëm për interesa të ndryshme. Është diskutuar për ekstremizmin e dhunshëm por duhet të ndërmerreni hapa konkretë për shkak se kemi qenë si komunë në top lajmë dhe nuk jeni marr me ata persona por përkundrazi vetëm çka i keni revoltuar më shumë . Për çështje të dukurive negative kam diskutuar në kuvend dhe nuk keni ndërmarr masa por përkundrazi i keni mbuluar që nuk është në rregull sepse nëse i doni fëmijët e dikujt sikur fëmijët e juaj është dashur me u marr me këtë çështje. Për çështjen e rrahjes së tre qytetarëve tonë që ndodhi në Maqedoni komuna është dashur me i ndihmuar personat që me bërë padi private e jo vetëm me bërë temë diskutimi.

Sead Vila thekson:- në pikat të cilat janë më të ndishme është mirë që me pasur kujdes sidomos për fëmijët të kufiri, rruga që shkon në drejtim të fshatrave, të dy qendrat sportive që kalojnë fëmijët, rruga në magjistrale të cilën e kalojnë nxënësit për në shkollë, adoleshentët të cilët rijnë deri në orët e vona. Është mirë që këto pika të cilat i përmenda policia me pasur kujdes. Duhet të kenë kujdes policia edhe për disa të rinj të cilët po i vozisin motorrët me shpejtësi të shpejtë.

Mefail Suma thekson:- të çështja e kyçjes së fshatrave të cilat janë në anën e djathtë të rrjedhjes së lumit Lepenc për me u këqyr për me dal në qendër me automjet është vështirë për shkak kolonës e cila bëhet nuk kanë mundësi të kyçur apo të ç'kyçen. Gjatë bisedës që kam pasur me një polic ai ka potencuar që komuna ka mundësi me vendosë një semaforë. Edhe pse është shenja që automjetet të cilat shkojnë për Shkup duhet të ndalohen por ata nuk e zbatojnë.

Rufki Suma thekson:- pavarësisht se e kemi rregulluar ndiçmin në KKSBB bisedohet sepse ka raste të cilat djegën dhe dikush nga anëtarët e këshillit e paraqet si problem. Për problemin të kufiri që u përmend e kemi diskutuar me policinë kufitare, e kemi dërguar edhe në shkrim në nivel qendrorë dhe kemi kërkuar edhe variantin për semaforë por është dilema se nëse bëhet me minuta ka raste që banorët e Seçishtë apo të fshatrave të tjerë që duhet të presin edhe pse ndoshta asnjë veturë nuk është. Ne i kemi propozuar që me pasur shirit të veçantë por nuk është bërë. Komuna ka bërë reagim zyrtarë për çështjen e rrahjes së qytetarëve tanë dhe përveç reagimit zyrtarë kemi ndërmjetësuar privatisht dhe palët kanë bërë padi në inspektorat. Janë mbajtur ligjëratat për dukuritë negative dhe për mjetet piroteknike si rezultat i takimeve që i kemi pasur në KKSBB. Janë mbajtur edhe trajnime me nxënës dhe grupe të interesit përmes organizatave të ndryshme të cilat merren me këtë çështje. Për çështje të pengesave ka kërkesë prej qytetarëve që me u vendosë por kërkesa ka më shumë që me u hequr dhe për atë është problem. Në momentin që është bërë plani për rregullimin e hekurudhës kemi biseduar dhe i kemi paraqitur vërejtjet tona se ku duhet të jenë vendet e lira për këmbësorë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- materialin e keni pranuar me kohë. Mandati i këshillave të fshatrave ka përfunduar në muajin prill por për shkak të pandemisë nuk kemi mundur me i organizuar zgjedhjet për këshilla të fshatrave.

Mefail Suma thekson:- më intereson forma e veprimit të këtyre këshillave të fshatrave për shkak se kemi marr vendim dhe kemi potencuar se do të jetë vështirë të zbatohet dhe po shihet që nuk po hynë në zbatim sepse për deri sa i kemi dy vendime është një hamulli dhe pse nuk zbatohet vendimi i ri ju e dini vetë. Titulli i rendit të ditës është informatë mbi aktivitete të këshillave lokale të komunës në Han të Elezit, ndërsa shënon raport i aktiviteteve të administratorit të Han të Elezit a është për një individë apo për këshill për shkak se Hani i Elezit ka këshill të vetin dhe administratori raporton vetëm në vetën e parë. Më pëlqen raporti i kryetarit të këshillit të fshatit Gorancë i cili i ka paraqitur me datë dhe foto të gjitha punët të cilat janë kryer. Administratorët e tjerë as në vetën e parë nuk kanë dhënë kurrfarë raporti por as në përgjithësi duke e marr fshatin Seçishtë i cili disa herë nuk ka paraqitur raport, fshati Dimcë nuk ka paraqitur raport por edhe disa fshatra të tjerë nuk kanë paraqitur raport. Administratori i Hanit të Elezit me sa kam informata është si kryeadministratorë dhe duhet më tepër ti nxitë administratorët e tjerë të fshatrave që të punojnë.

Sead Vila thekson:- është mirë të japin një raport më të mirë sepse se ka gjëra që i kanë identifikuar dhe disa informacione të cilat i kanë paraqitur nuk duhet të jenë në raport.

Kryesuesi thekson:- ju duhet t'i jepni vërejtje ndaj atyre të cilët nuk kanë paraqitur raport që do të thotë që ose nuk e njohin pozitën e vetë ose janë zgjedhur dhe nuk ndien përgjegjësi. Ata të cilët nuk kanë paraqitur raport e kanë dëmtuar veten sepse të jesh kryetarë fshati dhe nuk e shënon asnjë aktivitet nuk është mirë për shkak se duhet të mburreni me punën tënde që e keni bërë katër vite apo tetë vite sepse vijnë gjenerata të tjera. z.Florim Shkreta është këshilltarë i kuvendit dhe nuk i paraqet raport këtij kuvendi për punën e këshillit të fshatit. Seçishtë dhe fillimisht neve na mohon dhe ndërkohë e mohon edhe pozitën e vetë. Në fshatin Seçishtë më së shumti është investuar dhe emri jot ka pasur me mbetur në histori dhe duhet të mburreni me punën e juaj, mirëpo raport asgjë nuk ke shënuar.

Florim Shkreta thekson:- administratori i fshatit zgjidhet nga banorët e fshatit dhe duhet të bashkëpunon me komunën por komuna me nuk bashkëpunon dhe arsye nuk e di pse. Pavarësisht se investimet janë në bërë në fshatin tim nesër mund të bëhen edhe në fshatrat e tjerë. Me kënaqësi kisha dhënë raport por komuna nuk bashkëpunon, komuna mi ka ndaluar disa projekte të cila kam mundur me i nxjerr prej kompanisë "Sharrcem" dhe për shkak se komuna nuk bashkëpunon me mu projektet shkojnë dika tjetër por përkundrazi si administratorë me kanë nxjerrë para aktit të kryer sepse në takimet që i kam pasur me banorët dakordohemi për ndonjë vendim ndërsa në anën tjetër komuna vendosë krye në veti. Në rastin e pandemisë nuk ka pas bashkëpunim me administratorët dhe inspektori dhe drejtori tu ndahu ndihma, mirëpo z.Amir Bushi nuk e dinë fshatin tim më mirë se sa e di unë sepse ai bazohet në listë që marrin për çdo muaj. Raport u jap fshatarëve të mi që më kanë zgjedhur.

Teuta Shkreta thekson:- çështja e raportit është shumë send i mirë për shkak se raporti jetë në dosje. Kam parë disa raste që z.Florim Shkreta ka punuar dhe është dashur me raportuar. Drejtori i administratës është mirë me ju rekomanduar kryetarëve të këshillave të fshatrave se cilat aktivitete duhet të shënohen në raport e cilat jo. Raporti i kryetarit të këshillit të fshatit Gorancë 80 % ka qenë në rregull.

Isni Bushi thekson:- pesë nga administratorët e fshatrave nuk kanë paraqitur raport, a keni biseduar me këto administratorë për çfarë arsye nuk kanë dërguar raport. z.Florim Shkreta potencojë që nuk kam bashkëpunim dhe çfarë bashkëpunimi kërkon drejtor me komunën dhe nëse edhe administratorët e tjerë i ke ftuar përmes telefonim për me dërguar raport dhe nuk ka dërguar raport, kërkoj sqarim.

Florim Shkreta thekson:- unë jam deklaruar në kuvend që raport nuk sjelli për shkak se nuk kam bashkëpunim dhe kjo e nënkupton që kjo është raport. Rasti i fundit të pikës së gjashtë të mbledhje së kaluar te burimi deri nën breg të gjithë banorët e dinë që ajo pjesë ka qenë me u bërë e hapur. Unë nga kryetari i komunës kam kërkuar që ta bënë një takim me banorët dhe tu a tregojë një realitet se kështu është ka ndodhë dhe nuk merret parasysh por në mënyrë të fshehur organizon takim me banorët dhe merr vendim pa dionin e administratorit dhe kjo është nënçmim. Me kënaqësi kisha bashkëpunuar dhe nuk më intereson çështje partie por nuk është mirë që administratorin me ulur aq poshtë sa nuk bënë sepse nuk është duke u paguar askush por komuna të paktën duhet të na respekton. As me i njoftuar banorët nuk na keni lënë dhe nuk na ka mbetur kur një far autoriteti dhe jo rastësisht nuk jam vetëm unë i cili nuk kam dërguar raport.

Nora Xhoni thekson:- nëse zgjidhem administratore e Lagjes së Re unë nuk duhet ta shikoj se a bashkëpunon kryetari i komunës me mu apo jo, por unë duhet të bashkëpunojë për hir të fshatarëve. Kryetari i këshillit të fshatit Gorancë ka bërë një raport të mirë pavarësisht pse i ka shënuar të gjitha imësiat raporti është i mirë. Po që se do ti paraqite aktivitet e këshillit të fshatit Seçishtë z. Florim Shkreta do të ja shkonte Prishtinë e jo Hanit të Elezit dhe është mirë të bashkëpunoni për hir të qytetarëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- në biseda që kam pasur me z. Florim Shkreta i kam sugjeruar që të sjellë raport dhe me fjalë t'i paraqet që kam kërkuar me bashkëpunuar me organet e komunës por ata nuk më ofruan dhe mundesh me i shënuar aktivitete të cilat janë bërë pa bashkëpunimin e administratorit të fshatit. Raporti duhet të përmbajë se çka është bërë pa bashkëpunim të administratorit dhe pastaj e kishim diskutuar edhe më shumë sepse ishte parë mos bashkëpunimi me çdo administratorë. Drejtori i administratës duhet të ketë një qasje më serioze të bashkëpunimit në këtë aspekt.

Rufki Suma thekson:- në prill i ka skaduar mandati këshillave të më parshme dhe në këtë vit duhet të punohet në bazë të rregullores së re e cila është miratuar por për shkak të pandemisë nuk janë zhvilluar procedurat për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Drejtori i administratës është vetëm kordinatorë e vetëm i grumbullon raportet e kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe i përcjell për kuvend por nuk e ka të drejtën me ndërhyjë brenda raportit, mirëpo vetëm mund të jep këshilla dhe rekomandime për çështje të raportit. Pavarësisht sa janë aktiv kryetarët e këshillave të fshatrave ne i ftojme dhe i njoftojme e nuk ka punë që kryhet e që nuk ftohen kryetari i këshillit të fshatit. Ndihamat kur janë shpërndarë janë ftuar kryetarët e këshillave të fshatrave. Ka raste kur me një fshat mund të ndahen vetëm katër pako edhe nga kryetari i këshillit kërkohet listë për katër familje dhe nuk paraqet listë për shkak se i ka dhjetë familje skamnore dhe më mirë është që problemin me bartë në komunë e me pasur arsye për çështje të shpërndarjes. U përmendë që komuna e ka qitë para aktit të kryer por kush e ka ndalur z. Florim Shkreta apo ndonjë kryetarë të këshillit tjetër që me mbajtur mbledhje me banorë për me biseduar për çështje të ndryshme.

Florim Shkreta thekson:- nuk është e vërtetë që kryetari më ka ftuar për me treguar se këto janë për fshatin. Seçishtë e këto janë për fshatrat tjerë por unë kam kërkuar që të kemi konsulta të vazhdueshme në mes entit social me administratorët sepse më mirë zgjidhet problemi dhe nuk mbetet dikush mangut. Kryetari potencojë që nuk më ka ndalur askush që me mbajtur mbledhje me fshatin është e vërtetë, mirëpo nuk është mirë me më qit para aktit të kryer sepse tek e fundit administratori është për diçka. Ju jeni ata që keni zbehur motivin e interesit që më shumë se gjysma e kryetarëve të këshillave nuk paraqesin raport, pra e keni zbehur interesin e një administratori për me bashkëpunuar me ju.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-mars 2020 është në shumë prej 494,651.38 € apo 18.04 %. Prej tyre për paga dhe shtesa janë shpenzuar 371,118.56 € apo 24.43 %, në mallra dhe shërbime 48,212.74 € apo 15.90 %, në shërbime komunale 10,557.18 € apo 17.60 %, në subvencione dhe transfere 4,600.00 € apo 7.53%, në shpenzime kapitale 60,162.90 € apo 9.55 % dhe në rezervat 0.00 €. Të hyrat vetanake për këtë periudhë tremujore 2020 janë realizuar në shumë prej 49,108.24 € apo për 4,519.97 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2019.

Sabedin Hasallari thekson:- shpenzimet për mallra dhe shërbime ka një rritje prej 27.5 % duke e krahasuar me vitin paraprakë, ndërsa te subvencionet kemi një zbritje. Kërkoj sqarim se ku qëndron arsyeja. Shpenzimet kapitale arrijnë vlerën 60,162.90 € dhe pse nuk është paraqitur edhe për tre mujorin e viti paraprak me qëllim që me ditur se si ka shkuar performanca e shpenzimeve kapitale.

Shabi Rexhallari thekson:- kategoria e mallrave dhe shërbimeve ka një rritje prej 27.5 % për shkak se në fund të vitit 2019 kemi dalur me 36 000 € nga viti 2019 dhe jemi detyruar me i paguar borxhet dhe shpenzimet të cilat janë bërë në këtë tre mujorë. Te kategoria e subvencioneve kemi një zvogëlim në krahasim me periudhën paraprakë por për shkak të pandemisë nuk kemi bërë shpallje publike për klubet sportive dhe për atë nuk kemi pasur shpenzim më tepër. Te kategoria e investimeve kapitale janë shpenzuar 60,162.90 € por pasi në vitin e kaluar ka qenë i kontraktuar projekti i shtëpisë së kulturë i cili ka qenë projekt dy vjeçar dhe punët të cilët janë bërë kryhen me situacione, ndërsa krahasimin e kin në faqen gjashtë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

9. Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- nga ky raport i auditorit të përgjithshëm del që Komuna e Hanit të Elezit i ka pasur shtatë rekomandime dhe brenda tridhjetë dite prej atij momenti kërkohet të përgatitet plani i veprimtari mbi adresimin e rekomandimeve dhe i dërgohet zyrës kombëtare të auditimit dhe i dërgohet edhe kuvendit të komunës. Pastaj përgatitet raporti në mënyrë që me shikuar se sa kemi arritur të i zbatojmë ato rekomandime . Nga shtatë rekomandimet të cilat janë dhënë komuna e Hanit të Elezit i ka zbatuar katër rekomandime plotësisht dhe tri rekomandime pjesërisht. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- a ka komuna auditorë të brendshëm komuna.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a duhet të ketë komitete të auditimit.

Sabedin Hasallari thekson:- niveli i ulët i inkasimit të taksave komunale a e ka drejtoria një raport për gjitha subjektet të cilat i kanë mbetur më herët borxh komunës dhe është mirë që me i identifikuar mos me mbetur si biznese në Han të Elezit fiktive.

Shabi Rexhallari thekson:- rekomandim gjashtë ka të bëjë me mungesën e njësisë së auditimit të brendshëm. Më herët ka qenë një udhëzues se nga një deri në tre milionë euro nëse ka komuna buxhet duhet ta ketë një auditorë. Në fillim të vitit 2019 qeveria e ka miratuar një rregullore të re që komunat të cilat i kanë mbi tre milion euro duhet me pasur auditorë dhe komunës nuk i takon me pasur auditorë për shkak se nuk e ka buxhetin tre milion euro. Sipas kësaj rregullore komuna duhet të bëjë kërkesë për auditim të brendshëm në departamentin e financave që me hyjë në planin e Ministrisë që ata pastaj do të vijnë në komunë dhe ta bëjnë auditimin e komunës. Kërkesa është marr përsipër dhe kanë filluar auditimin dhe tash e kanë dërguar draftin. Komuna është duke i dhënë komentet dhe pastaj drafti bëhet raport dhe do të përcillet për kuvend. Komiteti i auditimit formohet pasi që të formohet njësia e auditimit të brendshëm dhe në momentin që nuk kemi auditorë nuk kemi drejtë me themeluar këtë zyre. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka iniciuar procedurat duke i njoftuar që me i kryer pagesat përmes kontratave. Për disa biznese nuk kanë mundur me gjet adresën për me i njoftuar. Për dhjetë biznese ka iniciuar procedura përmbartimore.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

10. Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi dërguar diçka të veçantë me shtuar nuk kam.

Florim Shkreta thekson:- pasi është publikuar lista e përfituesve është rishqyrtuar. Studentja znj.Natyra Kalisi ka parashtruar ankesë dhe në far forme e ka parashtruar ankesën. Komisioni për shqyrtim të ankesave i ka shqyrtua edhe njëherë të gjitha aplikacionet dhe ka vrenjtë se është bërë një lëshim ku një studente (Alma Curri) dhe në bazë të cilit nën është bazuar që nuk i takon bursa. Kërkoj sqarim si e konsideroni humbjen e vitit.

Sabedin Hasallari thekson:- pasi është bërë publike emri i studentes është kthyer prapë dhe a duhet me dhënë dikush përgjegjësi për shkak se krijohet një përshtypje që nuk është puna në rregull. A është njëjtë sikur me përsëritur vitin apo sikur me pauzuar.

Besarta Suma thekson:- nëse dikush e humb vitin për shkaqe shëndetësore a mund të jetë përfitues i bursës nëse e dëshmon me dokument mjekësorë.

Kryesuesi thekson:- a është e nevojshme me u bërë plotësim ndryshim i kësaj rregullore.

Menduh Vlasi thekson:- viteve të kaluara kur është hartuar lista i kam ftuar të gjithë studentët në takim dhe e kam prezantuar me sllajde, mirëpo në këtë vit për shkak të pandemisë nuk kemi mundur me organizuar një tubim të tillë. Ankesa është bërë me shkrimë në formë zyrtare dhe e kemi përcjell te komisionin për shqyrtimin e ankesave dhe komisioni është detyruar me i rishqyrtuar dokumentet dhe gjatë shqyrtimi është vërejtur se studentja një fjalë është e njëjtë sikur studentja që ka parashtruar ankesë. Ankesa është kthyer negativ por edhe studentja Alma Curri është hequr nga lista dhe në listë ka hyjë kandidati që i ka plotësuar kriteret në bazë të nenit 15 pika 1.7. Sa i përket përgjegjësisë gabimet bëhen kudo por është rregulluar kjo punë. Për komisionin humbje vitit është nëse ky studentë nëse e ka kryer maturën në vitin 2017 e është regjistruar në vitin 2019 dhe komisioni nuk ka mundësi me ditur se a e ka humbur vitin apo ka pauzuar, kjo vlen për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë e më tutje komisioni nuk ka shënime se a ka qenë studenti i sëmur apo jo por bazohet në regjistrimin e viteve. Gjatë implementimit kemi vërejtur se kemi probleme diku diku por ndarja e bursave është bërë konformë në bazë të rregullores.

Sabedin Hasallari thekson:- pasi është publikuar lista në tabelën e shpalljeve përgjegjësia është e komisionit dhe komisioni a është konsultuar me drejtorinë.

Florim Shkreta thekson:- sa kam mundur me vërejt ju është bërë e padrejtë studentes Alma Curri por neni 15 pika 1.7 studenti apo studentja nëse një herë ka përsëritur vitin apo ndërruar fakultetin e humbë të drejtën e bursës dhe unë mendoj që përsëritje e viti është nëse është regjistruar në fakultet.

Menduh Vlasi thekson:- po komisioni është konsultuar dhe bëhen gabimet por përmirësohen. Për vitin e parë kërkohet diploma testi i maturës dhe regjistrimi në vit.

Mehmet Ballazhi thekson:- realisht vetë rregullorja kërkon plotësim ndryshime dhe gjatë diskutimit që po i bëjmë Drejtori për Arsim është mirë me i shënuar sepse mund të harrohen. Ka raste që studenti nuk është regjistruar e nuk e ka humbur vitin dhe ky është në vitin e dytë kurse ai në vitin e parë. Studenti nëse ka një arsye shëndetësore që nuk është për fajin e atij studenti apo studentes duhet të përfshihet brenda rregullores propozimi i znj.Besarta Suma.

Sabedin Hasallari thekson:- a ekziston mundësi për nxënësit e shkollës së mesme të komunës së Hanit të Elezit me ju ndarë bursa ata të cilët janë raste sociale.

Menduh Vlasi thekson:- mundësia ekziston nëse kuvendi i komunës i planifikon mjetet financiare.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

11. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për tre mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sabrije Krasniçi thekson:- nëse një familje e ka pasur kantinierin bashkë dhe në momentin që janë ndarë familjes tjetër nuk i është dërguar kontinierë.

Kujtim Dernjani thekson:- nëse është lajmëruar te kompania dhe nëse nuk ju është dhënë është përgjegjësi e kompanisë por nuk kanë parur kantinierë.

Mefail Suma thekson:-kur do të bëhet furnizimi me kontinierë për shkak se janë dëmtuar kontinerët.

Kujtim Dernjani thekson:-në kuadër të projektit për mjedis të pastër komuna është përfituese e projektit dhe mjetet financiare do të dedikohen për kontinierë.

Sead Vila thekson:- të gjitha informatat apo raportet të cilat diskutohen dhe miratohen në kuvendin e komunës e kanë një person përgjegjës dhe nga kush është hartuar ky raport.

Kujtim Dernjani thekson:- zyrtari financiarë e harton raportin e kompanisë dhe e dërgon te kryesuesi i aksionarëve dhe pastaj përcillet për shqyrtim në KPF dhe në kuvendin e komunës .

Nora Xhoni thekson:- a janë paguar punëtorët e kësaj kompanie me pagë shtesë në kohë pandemie.

Kujtim Dernjani thekson:- është problem qeveritarë, mirëpo kompania i ka subvencionuar me orë shtesë.

Mehmet Ballazhi thekson:- kontinierin të cilin e keni dërguar në Pustenik është mirë që më shpesh me i bartur mbeturinat apo me dërguar edhe një kontinier.

Hanumshahe Dibrani thekson:- nga kush kryhet pastrimi në rrugën e cila është për rreth hekurudhës.

Kujtim Dernjani thekson:- punëtorët e kompanisë e bëjnë pastrimin e asaj rruge por janë duke u zhvilluar procedurat e tenderimit që me u bërë ndriçimi edhe në atë pjesë.

Teuta Shkreta thekson:- punëtorët e kompanisë duhet të ndihmohen me mjete financiare për punën të cilën e kanë bërë në këtë kohë pandemie.

Sabedin Hasallari thekson:-fitimi neto për tre mujorin e parë është për lëvdata dhe duhet ta keni parasysh se në tre mujorin që do të hyni situata nuk do të jetë e njëjtë për kompaninë për shkak se ka ndikuar pandemia te qytetarët. Kontratën të cilën e keni bërë me një subjekt afarist nuk është mirë të shkoni në ata mënyrë sepse paraqiten edhe subjekte të tjera afariste për me vazhduar në atë mënyrë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

12. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- pavarësisht se si ka dhënë përgjigje Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është treguar i përgjegjshëm sepse ka pas të bëjë për vendimin që është marr për përjashtimin e nxënësit në shkollën e mesme "Dardania" por është përgjigje pak nënçmuese për shkak se ka potencuar se nuk e di se për cilin nxënës dhe i bien pak hajgare. Ne këtë e kemi diskutuar me drejtorin dhe drejtori ka potencuar që është e vërtetë, kemi marr masa dhe është përjashtuar por është gjithçka në rregull. Këtij nxënësi ju është bërë padrejtësi sepse ka pasur edhe koleg të tjerë dhe kjo nuk më ka pëlqyer. Prej zyra së prokurimit nuk është dhënë përgjigje dhe përsëri i kërkojë përgjigje me shkrim prej zyrës së prokurimit. Faqja zyrtare e komunës a është për të gjithë qytetarët apo vetëm për disa për shkak se ka vërejtje prej qytetarëve sepse po bllokohen që mos me pasur qasje dhe nuk po munden me u informuar. Faqja e komunës duhet të jetë më transparente sepse si pasojë e kësaj faqe qytetarët i kanë humbur të drejtat për aplikim të pagës prej 130 € që ndërlihet me entin e punësimit për shkak se fillimisht për aplikim ka qenë vetëm me letërnjoftim dhe të figuron si pa punë, mirëpo ndërkohë ka ndryshuar rregullorja dhe është dashur me i plotësuar disa formularë në komunë dhe njoftimi është bërë përmes komunës ndërsa faktikisht kanë qenë të bllokuar dhe nuk kanë pasur informim. Te çështja e punësimeve a do të ketë ndonjë herë konkurs publik siç duhet pa u ditur personi se kush ka me u pranuar dhe me qenë i barabartë për të gjithë personat të cilët aplikojnë, apo siç ke rasti i fundit siç u punësua z.Sami Stagova dhe djali i vllahut nënkryetarit të komunës sepse për këtë unë e kam ditur para se me u shpall konkursi. A do të ketë kufij kjo çështje si ekzekutivë. Kërkoj sqarim për vendimin e viti 2014 për nënat lehona të cilët subvencionohen me nga 100 € sepse kam pasur rast për te unë por nuk është problem edhe pse më është bërë e padrejtë. Kam aplikuar me vonesë për njërin fëmijë kam aplikuar ende pa u bërë një vit kërkesë për fëmijën e parë tri vite. Përgjigja për djalin më është kthyer pozitive kurse për vajzën që është tre vite më është refuzuar kjo e drejtë. Në përgjigjen që më është dhënë potencohet që për shkak të vonesës që fëmiju i ka katër vite e mbi por fëmiju ende nuk i ka mbushur katër vite. Unë mendoj që është dashur me pasur ndonjë periudhë kohore që çdo familjarë apo prind që aplikon pas këtij afati u humbet e drejta. Unë kërkojë që të ndryshohet ky vendim.

Menduh Vlasi thekson:- më mirë do të ishte që potencohet që kuvendi me ndryshuar këtë vendim për shkak se nuk është i mirë. Vendimi është i kuvendit dhe ka lënë hapësirë që me potencuar që pas tri vite nuk mund të jesh përfitues. Pasi është vendimi i kuvendit të komunës duhet që prej anëtarëve të kuvendit të komunës me propozuar që vendimi me u ndryshuar dhe me përcaktuar kohën.

Mefail Suma thekson:- ka të drejtë z.Florim Shkreta sepse nuk është përcaktuar afati në vendim.

Sead Vila thekson:- nga kush është bërë përzgjedhja e pjesëmarrësve të cilët kanë marr pjesë në punëtorinë nga data 6 deri me 8 mars e cila është mbajtur në Mavrovë për planin zhvillimorë për shkak se i vetmi unë nga kuvendi i komunës kam mbetur i pa përfaqësuar sepse grupet tjera parlamentare ishin të përfaqësuar. Këtë veprim selektiv e quaj tendenciozë dhe me qëllim të caktuar dhe nëse është bërë pavetëdije në seancën e radhë kisha dashur me më sqaruar ata të cilët kanë qenë organizatorë.

Kryesuesi thekson:- të gjithë e dinë që organizimin e ka bërë Drejtoria për Urbanizëm dhe prej kuvendit nuk e kam caktuar askënd. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Procesmbajtësi

Avni Bushi

